



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 22
Prishtinë, më 8 korrik 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 8 KORRIK 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri HAMITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kryetari i njoftoi deputetët me Vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për zëvendësimin e deputetit Sasha Rashiq, nga subjektit politik SLS, me deputetin Milivoje Stojanoviq, të cilit i dëshiroi punë të mbarë.

Kryetari ftoi deputetin Stojanoviq që të nënshkruaj deklaratën e betimit.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 30 qershor 2011,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale,

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës,
7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Berat Buzhala, Anton Quni, Burim Ramadani, Afrim Kasolli, Amir Ahmeti, Arsim Bajrami, Vesna Mikiq, Hamza Balje dhe Nait Hasani. Diskutimet e plota të deputetëve janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Visar Ymeri, parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me privatizimin e PTK-së pas aktakuzave të ngritura kundër drejtorit të përgjithshëm dhe kryetarit të bordit të PTK-së.

Në mungesë të kryeministrit Thaçi, në pyetjen e lartshënuar u përgjigj ministri Besim Beqaj.

Deputeti Bekim Haxhiu, parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani lidhur me veprimet e Ministrisë së Shëndetësisë për joshjen e mjekëve dhe të personelit profesionistë shëndetësorë për të mos u larguar nga QKUK-ja, në klinikat private.

Ministri Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Haxhiu.

Deputeti Bekim Haxhiu, parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani lidhur me shkeljen e statutit të QKUK-së, me rastin e publikimit të konkursit të për drejtor të kësaj Qendre Klinike.

Ministri Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Haxhiu.

Deputetja Lirije Kajtazi, parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq lidhur me veprimet e Qeverisë për rregullimin e statusit të pensionistëve – qytetarë të Kosovës, të cilët kanë punuar deri në moshën e pensionit në Zvicër.

Ministri Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetes Lirije Kajtazi.

Deputetja Aurora Bakalli, parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani lidhur me sanimin e gjendjes së rëndë në furnizimin e sektorit publik me barëra dhe material shpenzues, veçmas në QKUK.

Ministri Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Aurora Bakalli.

Deputeti Agim Kuleta, parashtroi pyetje për ministrin Dardan Gashi lidhur me qëndrimin e ministrisë që ai drejton për mos funksionimin e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe mos menaxhimin e vlerave të rralla të trashëgimisë natyrore në Kosovë.

Ministri Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetit Kuleta.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur me 30 qershor 2011

Kuvendi miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e mbledhjes plenare të datës 30 qershor 2011.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale

Kryesuesi, **Sabri Hamiti**, ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale.

Zv. kryeministri dhe ministri i drejtësisë, **Hajredin Kuçi**, në fillim të fjalës së tij tha se Ministria e Drejtësisë, në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore ka përgatitur Projektligjin për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale, të cilin po e shqyrtojmë sot, në parim.

Në vazhdim, ministri Kuçi theksoi se Projektligji për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale parasheh rregullimin e përgjegjësisë së personave juridikë për vepra penale, sanksionet penale të cilat mund të zbatohen ndaj personave juridikë dhe dispozitat e posaçme që e rregullojnë procedurën penale të zbatueshme ndaj personit juridik.

Më tutje, ai u fokusua në rregullativën ligjore aktuale nga kjo fushë, e cila nuk është e mjaftueshme dhe gjithëpërfshirëse sa i përket përgjegjësisë penale të personave juridikë.

Me këtë projektligj gjithashtu parashihet që përveç personave juridikë që do të përgjigjen, njëkohësisht nën përgjegjësinë penale do të vihen edhe personat fizikë të cilët kanë përgjegjësi në kuadër të personit juridik, theksoi ai.

Në fund, ministri Kuçi kërkoi miratimin, në parim, të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Legjislacion, Arben Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Arsim Bajrami, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Jeton Svirca, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 64,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale.

Zv. kryeministri dhe ministri i drejtësisë, **Hajredin Kuçi**, tha se dispozitat e këtij Projektligji kanë për bazë dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe konventat ndërkombëtare nga kjo fushë, si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Në vazhdim, ministri theksoi se Projektligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale rregullon kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike ndërkombëtare në çështjet penale në qoftë se me marrëveshje ndërkombëtare nuk është caktuar ndryshe apo nëse nuk ekziston marrëveshja ndërkombëtare.

Më tutje, ministri Kuçi konstatoi se në mungesë të një marrëveshjeje ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe shtetit të huaj, ndihma juridike ndërkombëtare mund të ofrohet mbi bazën e parimit të reciprocitetit.

Në fund, ministri Kuçi kërkoi miratimin, në parim, të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Arben Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Behar Selimi, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Suzana Novoberdaliu, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Mufera Shinik, si dhe deputetët: Hydajet Hyseni, Safete Hadergjonaj dhe zv. kryeministri Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 77,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Ekspozenë për këtë Projektligj e paraqiti ministri, **Bajram Rexhepi**, i cili tha se arsyet e nxjerrjes së këtij Projektligji kanë të bëjnë me mungesën e funksionalitetit të legjislacionit në fuqi, si dhe harmonizimin e Projektligjit për arsimin parauniversitar me dispozitat e Kushtetutës së Kosovës.

Në vazhdim, ministri theksoi se Projektligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës rregullon edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në nivelin 4, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të të rriturve të cilët marrin kualifikime në këto nivele.

Në fund, ai kërkoi miratimin, në parim, të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Idriz Vehapi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Vataj, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Eqrem Kryeziu, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Jeton Svirca, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Enis Kervan, si dhe deputetët: Xhevahire Izmaqu, Gëzim Kelmendi, Amir Ahmeti, Duda Balje, Emilija Rexhepi, Kymete Bajraktari, Mufera Shinik, Ganimete Musliu dhe nënkryetari, Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 69,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010

Deputeti **Ramiz Lladrovci**, në emër të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010, dhe

kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare, bashkë me rekomandimet e komisionit funksional.

Deputetja **Safete Hadergjonaj**, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa tha se kemi shqyrtuar Raportin në fjalë dhe kemi rekomanduar miratimin e tij.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramiz Lladrovci, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bali Muharremaj, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët: Venera Dibra dhe Salih Morina, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010, bashkë me rekomandimet e komisionit funksional. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	70,
Kundër-----	1,
Abstenime-----	3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2010, bashkë me rekomandimet e komisionit funksional.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 14:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.